



### VENDIM

Nr.121 Datë. 01.12.2014

### PËR

## FILLIMIN E PROÇEDURAVE PËR LIÇENSIMIN E SHOQËRISË “FATLUM” SH.P.K NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “PERROLLAJ”.

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 gërma “a”, nenit 9 dhe nenit 13 pika 1, gërma “a”, të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “a”, dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108, datë 09.09.2008, nenit 18, pika 1, gërma “a”, të Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.03.2009, i ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 01.12.2014, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “FATLUM” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për liçensimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike te kësaj shoqërie,

### Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “FATLUM” sh.p.k plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në Rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave si më poshtë:

- Neni 9, pika 1,

Formati i plotësuar në mënyr korrekte.

- Neni 9, pika 2

Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor është plotësuar tërësisht.

- Neni 9, pika 3

Dokumentacioni financiar dhe fiskal është plotësuar tërësisht.

- Dokumentacionit teknik (Neni 9, pika 4.1.1 ;pika 4.1.2; 4.1.3;) janë plotësuar në mënyrë korrekte. (Dokumentacionit teknik Neni 9, pika 4.1.3 është plotësuar korrekt.
- Neni 9, pika 4.1.4 Dokumentacioni tekniko- ekonomik është plotësuar pjesërisht.  
( mungon plani i biznesit.)
- Leje nga institucione të tjera.( Neni 9, pika 4.4.5) është plotësuar tërësisht.

Për dokumentacionet e munguara, do të njoftohet subjekti që në bazë të “Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/të Pjesëhëm dhe Rinovimit të Liçensave”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, ti paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “FATLUM” sh.p.k për liçensim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Perrollaj” Fuqia e instaluar 0,5 MW.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



# REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË



Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s, për:

*VENDIMIN*

Nr.121 Datë. 01.12.2014

**PËR**

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LIÇENSIMIN E SHOQËRISË  
“FATLUM” SH.P.K NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË  
ELEKTRIKE NGA HEC “PERROLLAJ”.**

Anëtarët e Bordit

Pro

Kundër

**Petrit Ahmeti**

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

**Adriatik Bego**

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

**Abaz Aliko**

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

**Entela Shehaj**

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

**Maksim Shuli**

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_